

Integrimi

Nga të huajat dhe të huajt pritet, që të integrohen në shoqëri. Kjo përfshinë respektimin e ligjit, kujdesin financiar për veten dhe mësimin e gjermanishtes.

Parimet kryesore më të rëndësishme

Të gjithë banorët e Zvicrës duhet ta respektojnë Kushtetutën Federale (p.sh. barazinë midis burrit dhe gruas) dhe të respektojnë ligjet në fuqi. Pos kësaj pritet përkujdesja financiare për veten, nëse ajo është e mundur. Gjithashtu, nga të huajt kërkohet që sa më shpejt ta mësojnë gjuhën që flitet në vendin ku ata banojnë. Integrimi mund të ketë sukses vetëm nëse të dyja palët japin kontribut. Për këtë arsye popullsia vendase pritët të jetë e hapur ndaj të huajve.

Vetpërgjegjësia

Federata, kantonet dhe komunat kujdesen që të huajt të kenë çasje të drejtë në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Nga ana e tyre, të huajt duhet ta marrin përgjegjësinë për integrimin. Ata pritët të përfitojnë nga ofertat.

Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Shoqatat ofrojnë një mundësi të mirë për integrim në shoqërinë zvicerane dhe për njohje të njerëzve tjerë. Por edhe festivalet dhe ngjarjet në bashkësinë ku banoni gjithashtu janë të mira për krijimin e kontakteve. Fillimi ndonjëherë mund të jetë paksa i vështirë, ngase jo të gjithë banorët e Zvicrës janë njëlloj të hapur ndaj kulturave të huaja. Ndonjëherë duhet pak këmbëngulje.

Njoftime / mbështetje

Për të sapoardhurit në kantonin Aargau ka në dispozicion zyra të ndryshme kontakti. Vendi i parë i mirë për tu njoftuar gjithmonë është komuna ku jetoni. Mirëpo, ka edhe pika të tjera specifike për emigrante dhe emigrantë. Përveç zyrës qendrore për integrim Aargau (Anlaufstelle Integration Aargau, AIA), ka edhe disa zyra rajonale. Ato ofrojnë informacione për jetën në Zvicër dhe përgjigjen në pyetjet tuaja konkrete për tema të ndryshme. Nëse nuk flisni ende gjermanisht, mund të sillni dikë me vete për të përkthyer ose të kërkoni një përkthyes apo përkthyes. Disa zyra ofrojnë informacion edhe në gjuhë të tjera. Ka pika të veçanta kontakti për disa grupe gjuhësore.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.marhaban-aargau.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi